

# CAT MAGAZINE



## PËRFITIMET REALE NGA NJË BOTË VIRTUALE

PERFORMANCA PRECIZE TAKON  
RENDIMENTIN: HISTORIA ROTOTILT

NDEZJA PËR NJË TË ARDHME  
MË TË QËNDRUESHME

Teknoxgroup

CAT



# 1931 VËSHTRIM PRAPA I CAT



## MOTORI PATROL N.20, GRADUESI MOTORIK I PARË I CATERPILLAR.

I prezantuar 70-vjet më parë, motori patrol N.20 shënoi një hap të rëndësishëm në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve. Ishte i pari i një serie graduesish motorik Cat që kulmon sot në seritë M, duke na dhënë brezin më të fundit të sukseseve të teknologjisë.



Ky gradues motorik Cat 12G, i prodhuar në vitin 1978, ka shënuar deri në 40.000 orë pune. Duke qenë pronë e shoqërisë sllovaqe të ndërtimit Vion, ai është akoma në përdorim të rregullt, duke punuar për mirëmbajtjen e rrugëve.



Ndërtuar në vitin 1939, ky gradues motorik Cat numër 12, numri seria 1K9200SP, u importua në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2007, pasi kish kaluar jetën e punës së tij në Shtetin e Uashingtonin në veriperëndim të SHBA. Ai përdoret akoma herë pas here për të mirëmbajtur rrugët e transportit në një fasilitet riciklimi në Cambridgeshire, Angli.



Graduesi motorik më i fundit Cat 14 M përfaqëson një revolucion në efikasitetin operacionale, vizibilitetin, lehtësinë e shërbimit dhe rendimentin e përgjithshëm.



**NDEZJA PËR NJË TË ARDHME MË TË QËNDRUESHME**  
Zgjidhjet Cat mbështetin parqet detare të erës



**ÇUARJA EKZAKT NË KOHË NË AFRIKË**  
Duke ndihmuar Jean Jacques Le Moal që të lidhë njerëzit në të gjithë Afrikën



**KUR PERFORMANCA E PRECIZIONIT PLOTËSOJNË RENDIMENTIN**  
Rototilt i bën ekskavatorët më eficientë



**PREKJA E INOVACIONIT**  
Prekja e inovacionit, vizualizimi zhytës përmirëson projektin

**I dashur lexues,**

Një vit i suksesshëm tashmë. Caterpillar është duke bërë novacion të nivelit të lartë dhe duke bërë hapa të mëdha në të gjitha fushat e zakonshme si dhe disa hapa që mund tu surprizojnë – si për shembull në ujë.



Për 80 vjet Marina Cat ka siguruar fuqinë e anijeve më të mëdha të botës. Qofshin anije tregtare apo për argëtim, Cat dhe MaK kanë qenë forca shtytëse në industrinë e Marinës në të gjithë botën. Tani, me kërkesat gjithnjë e në rritje të energjisë, si Cat dhe MaK po sigurojnë zgjidhje të specializuara për anijet që u shërbejnë parqeve të erës në det.

Ashtu siç do ta prisnit nga Caterpillar, ne nuk e ndalojmë kurrë novacionin. Komponenti i ynë i ri Rototilt është një shembull i përsosur. Kjo shtesë e konstruktuar fort u jep ekskavatorëve një nivel të pabesueshëm të precizionit pikërisht aty ky nevojitet – në fund të punës. Me një rotacion prej 360 gradësh dhe 40 gradë anim, gërmimi, animi dhe rotacioni kryhen vetëm me një lëvizje.

Në këtë çështje, ju mund të hidhni një vështrim nga brenda në Qendrën Teknike Caterpillar. Këtu, së bashku me inovacione dhe zhvillime të tjera të pabesueshme, është vendi ku strehohet qendra jonë moderne e vizualizimit zhytës. Kjo teknologji e shquar u lejon njerëzve që të ndërveprojnë në një mjedis të vërtetë 3D dhe me një shkallë 1:1 ndërkohë që produktet janë akoma duke u ndërtuar. Si rezultat, zhvillimi është më i shpejtë dhe më eficient.

Qendra Teknike Caterpillar është vërtetë e mahnitshme. Por kur hyn ekzaktesisht brenda në të, biznesi ynë varet nga marrëdhëniet e forta me klientët dhe tregtarët tanë. Vini re se si projektet e ndërtimit të ndërtesave dhe ato civile në të gjithë Afrikën po ndihmojnë për t'i dhënë formë kontinentit dhe se përse një shoqëri përdor Caterpillar si standard me të cilin të gjitha pajisjet duhet të performojnë dhe sesi marrëdhëniet tregtarë/klientë duhet të funksionojnë.

Përfundimisht secili e di se Caterpillar ndërton pajisje të forta, tek të cilat mund të mbështetesh. Megjithatë, kur është përfundimisht koha për të transformuar pajisjet e përdorura mirë në gjendje si të reja, opsionet e rindërtimit të certifikuar Cat (CCR) dhe Power Train e certifikuar e energjisë (CPT) janë mënyra e përsosur me kosto efektive për t'i dhënë pajisjes tuaj Cat një jetë të dytë.

Shpresojmë që ky edicion t'ju gjejë duke punuar shumë dhe duke përfutur nga e gjithë linja e produktit Cat dhe novacionet që udhëheqin industrinë. Kudo që jeni dhe çfarë do qoftë biznesi juaj, ju mund të mbështeteni tek Caterpillar për të qenë aty kur nevojitet.

**Paolo Fellin,**  
**Zëvendëspresident i Caterpillar**

**PREKJA E NOVACIONIT**

Prekja e novacionit vizualizimi i përgjithshëm përmirëson projektin

4

**KUR PERFORMANCA ME PRECIZION PËRPUTHET ME RENDIMENTIN**

Rototilt i bën ekskavatorët më eficientë

8

**NDËRTO QË TË RINDËRTOHET**

Vëmendje detajeve

11

**NDEZJA PËR NJË TË ARDHME MË TË QËNDRUESHME**

Zgjidhjet Cat mbështetin parqet me erë jashtë shtetit

12

**TA ÇOJMË ATË EKZAKT NË KOHË NË AFRIKË**

Të ndihmojmë Jean Jaques Le Moal që të lidhë me njerëzit në të gjithë Afrikën

16

Sipër është thjesht një shije e asaj që ndodhet në këtë edicion – ju do të gjeni shumë më tepër lajme dhe pikëpamje brenda. Në qoftë se keni ndonjë ide për ndonjë ngjarje për edicionin e ardhshëm, kontaktoni botuesit tanë në [CatMagazine@cat.com](mailto:CatMagazine@cat.com)

**BOTUESI:** Ulrike Schwarzenzahl, Caterpillar S.A.R.L. **KRYEREDAKTOR:** Agnes Schroeter, Caterpillar S.A.R.L. **KOORDINIMI I TREGTARIT** Anneloes de Jong **SHKRUESI KRYESOR:** Nick Carding **DREJTIMI I ARTIT:** Ron Strik **FOTOGRAFIA:** Peter Verver **KONCEPTI DHE REALIZIMI:** Centigrade për Caterpillar S.A.R.L. [www.centigrade.com](http://www.centigrade.com) **KONTAKTI ME TREGTARËT VENDORË:** [info@teknogroup.com](mailto:info@teknogroup.com)

Revista Cat shpërndahet nga tregtarët e Caterpillar në Evropë, Afrikë dhe Lindjen e Mesme dhe CIS tre herë në vit. Ju lutemi dërgoni korrespondencën tuaj editoriale tek Cat Magazine, Caterpillar S.A.R.L. 76, Route de Frontenex, PO Box 6000, 1211, Gjenevë, 6, Zvicër. [CatMagazine@cat.com](mailto:CatMagazine@cat.com) Të gjithë të drejtat e rezervuara 2012 Caterpillar.





Galen dhe Abhishek virtualisht duke inspektuar shasinë e një ekskavatori të madh.

# PREKJA E NOVACIONIT

Qendra Teknike e Caterpillar ka një histori të ekspertizës në teknologjinë e vizualizimit zhytës – mjetet moderne po arrijnë shpejtësi dhe efikasitet të paparë në projektimin e produktit.

‘Ekselencia e zhvillimit të produktit që drejtohet’ kjo është fraza e zgjedhur për të përfaqësuar arsyen e ekzistencës së Qendrës Teknike Caterpillar. Kështu, si i projektoni dhe zhvilloni produktet më të mira të mundshme me kosto optimale në afatet më të ngushta të mundshme? Kjo është një pyetje që ka shqetësuar kërkuesit, teknologjistët dhe projektuesit në Mossville, Qendra Teknike e vendosur Illinois në SHBA për të gjithë kohën e ekzistencës së qendrës.

Përgjigjet, sigurisht, kanë ndryshuar gjatë viteve ashtu siç janë zgjeruar dhe mundësitë, por është e mundshme që të lexohet një pjesë e kësaj historie dhe progresi duke hedhur një vështrim brenda disa ndërtesave të fasilitetit – ashtu siç bënë vizitorët gjatë një dite të hapur të mbajtur në Shtator vitin e kaluar për të shënuar 50 vjetorin e Tech Center.

Shtatë ndërtesat e fasilitetit i kushtohen kërkimit dhe zhvillimit të sistemeve të makinave, sistemeve të fuqisë, komponentëve dhe proceseve të prodhimit që prekin çdo njërin nga 300+ produktet e Caterpillar. Ndërtesa L, për shembull, ka qenë shtëpia e testimit të motorit Cat që kur u hap Tech Center në 1961. Këtu, 106 qeliza testimi akomodojnë motorët eksperimental nga 100 hp deri në 9000 hp për testimin rigoroz të qëndrueshmërisë dhe emetimeve. Ndërtesa K strehon vërtetimin e procesit të kërkimit dhe prodhimit të strukturave të avancuara, ndërsa Ndërtesa D – më e reja në Tech Center – strehon laboratorin e madh të dinamikës strukturore të ngarkesës dhe pasagjerëve, e njohur zakonisht si tabelat lëkundëse. Duke përdorur teknologjinë moderne, riprodhojnë 20 orë nga dëmi i makinës në një orë të vetme testimi.

Por është Ndërtesa F ku ju ndoshta mund të merrni pamjen më të qartë të drejtimit në të cilin ecën teknologjia në Caterpillar.

Më tepër



Gjeni më tepër për:  
<http://www.caterpillar.com/innovation>





Nga e majta në të djathtë:  
Galen Faidley, Valerie Wiest  
dhe Abhishek Seth.

#### NDËRTESTA F – NJË TABELË DREJTUESE PËR TË NESËRMEN

Ndërtesta F e Tech Center strehon shumë aplikime të ndryshme të zhvillimit të produkteve virtuale – duke përdorur simulimin në vend të materialeve faktike për të zhvilluar dhe vërtetuar teknologjitë e reja dhe projektet e produkteve. Mes aktiviteteve të tjera, Ndërtesta F strehon kërkimin për motorë. Ajo strehon një prej tre mjeteve me spraj të temperaturave të larta që disponohen në të gjithë botën e cila mund të riprodhojë procesin e djegies të motorit saktësisht në një mjedis tavoline në një laborator. Shkencëtarët Caterpillar e përdorin këtë simulim për të analizuar impaktin e sprucos së karburantit në materialet e motorit me qëllimin e reduktimit të emetimeve të motorit, duke rritur efencën e karburantit, dhe duke përmirësuar qëndrueshmërinë e produkteve të motorëve Cat.

Ndërtesta F strehon gjithashtu një nga fasilitetet më novatore të zhvillimit të produkteve virtuale – qendrën moderne të Vizualizimit Zhytës.

Valerie Wiest, menaxheri i divizionit për dislokimin e zhvillimit të produktit virtual, ka një titull Doktor Shkencash në Mekanikën Teorike dhe të Aplikuar dhe është përfshirë në zhvillimin e produktit virtual që kur ajo u bashkua me shoqërinë në 1994. "Simulimi kompjuterik si një ndihmë për projektin filloi që në vitet 1970 dhe ne kemi përdorur teknologjinë e tipit të realitetit virtual për të rritur inxhinierimin e projektit që prej viteve 1990," në Wiest i tha një vizitori në një laborator të ri kohët e fundit. "Por teknologjia jonë e re e vizualizimit zhytës përfaqëson një hap të madh përpara sepse ajo lejon ndërveprimin njerëzor me një produkt ose mjedis virtual në një shkallë më të madhe shumë më herët në procesin e zhvillimit."

#### FAKTORIZIMI NË ELEMENTIN NJERËZOR

##### **Kështu, çfarë është vizualizimi zhytës dhe si e rrit ai procesin e zhvillimit të produktit?**

Galen Faidley, drejtues i ekipit për vizualizimin zhytës në Tech Center, ka një titull master në inxhinierimit kompjuterik dhe është specializuar në aplikimin e teknologjisë së realitetit virtual për të projektuar makina të reja që prej mbërritjes së tij në Caterpillar në vitin 2004. Së bashku me inxhinierin kërkues Madhor Abhishek Seth, i cili ka një titull Doktor Shkencash në inxhinierimin mekanik dhe ndërveprimin njerëzor – kompjuterik, ai është përfshirë nga afër në zhvillimin si të mjeteve edhe të aplikimeve të vizualizimit zhytës në Caterpillar. "Deri tani në zhvillimin e produktit virtual," deklaroi ai, "çdo gjë bëhej në monitorin e kompjuterit – vizualizim në desktop. Për këtë ju krijoni një model dixhital të projektit tuaj në një kompjuter, ndërsa mund të shikoni në ekran, ta rrotulloni atë dhe ta manipuloni si të jetë e nevojshme. Faktikisht ky është një prezantim 2D më tepër se sa

*"Vizualizimi zhytës shton një dimension të tretë të tretë të vërtetë dhe në një shkallë 1:1..."*

një prezantim i vërtetë 3D. Vizualizimi zhytës i shton dimensionin e tretë të vërtetë dhe me një shkallë 1:1, jo thjesht në një shkallë të vogël në një ekran kompjuteri."

Abhishek shton: "Ai e vendos qenien njerëzore të gjallë – qoftë ky një operator, teknik apo projektues produkti – faktikisht në mjedisin virtual bashkë me makinën, nënsistemin apo komponentin që po zhvillohet, dhe i lejon atij ose asaj që të ndërveprojë me botën e gjeneruar nga kompjuteri. Është pak a shumë si

Valerie, Abhishek, dhe Galen  
ecin përmes një fabrike të  
ardhshme Caterpillar.



kinemaja 3D, me përjashtim që ju faktikisht mund të rrethoheni nga produkti ose nga mjedisi që po krijoni.”

Në terma fizikë, sistemi i vizualizimit zhytës përbëhet nga një grumbull ekranesh dhe projektorësh që rregullohen përreth përdoruesit. “Imagjinoni një kub në të cilin të gjitha anët janë ekrane,” thotë Abhishek, “dhe ju fitoni idenë. Përdoruesi vesh syze të sofistikua 3D. Sistemi përdor kamera optike për të gjurmuar lëvizjet dhe pozicionet e përdoruesit në lidhje me gjithçka që shfaqet në ekrane. Komponentët e veçantë hardëare në fakt janë relativisht të thjeshtë – ekrane, kompjuterë, projektorë. Ato vihen në punë si një sistem i vetëm me modelin kompjuterik që është kompleks. Kemi kaluar 10 vite duke e zhvilluar këtë. Pika e kthesës erdhi kur ne mundëm të paketonim kompleksitetin brenda një sistemi të fortë dhe të lehtë për të përdorur. Ne e dislokuam atë në mënyrë që inxhinierët të mund të fillonin përdorimin e tij për të fituar rezultate praktike menjëherë.”

“Përdorimi i mjeteve zhytëse është shumë i ndryshëm nga studimi i projektit në një ekran kompjuteri,” shton Galen. “Trupi i njeriut dhe veprimet e tij janë shumë të vështira për tu simuluar. Por me vizualizimin zhytës nuk ju duhet që ta simuloni atë; faktikisht ju mund të keni qenie real njerëzore që ndërveprojnë me projektin tuaj virtual.”

#### “TANI NE MUND TË BËJMË MË TEPËR”

Mjedisi i parë i vizualizimit zhytës i Caterpillar’s u ndërtua në Tech Center në 1998. Pasi një zhvillim intensiv dhe teknologjia filloi të përdorej në shkallë të gjerë në 2007. Tani Caterpillar ka një numër sistemesh vizualizimi zhytës në fasilitetet e projektimit në të gjithë globin.

Kështu, çfarë përfitimesh shikohen? Valerie Wiest deklaron se ka shumë përfitime. “Thjesht fare, tani ne mund të ‘prekim’ më tepër produkte dhe e bëjmë këtë me

më efektivitet dhe shpejtësi se më parë. Nuk është thjesht një lodër e madhe e re që të luajnë projektuesit tanë – megjithëse e pranoj që ata priren që t’i fërkojnë duart dhe të thonë ‘sa mirë’ kur ekspozohen për herë të parë me të. Në radhë të parë janë klientët tanë që përfitojnë.

“Për shembull, në çdo makinë Cat parashikimi i shikueshmërisë së operatorit gjithmonë ka qenë një sfidë. Kur një projekt makine apo forme ndryshon, si mund të sigurohesh që operatori përsëri mund ta shikojë atë që duhet të shikojë? Tani është e thjeshtë, ju thjesht i vendosni operatorët në një makinë virtuale, ata ndërveprojnë me të dhe e përshtatin projektin përkatësisht. Të gjitha këto pa pasur nevojë që faktikisht të ndërtohet prototipi i makinës, kështu që kursehet në kohën dhe koston e zhvillimit dhe klienti merr një makinë më të mirë, në një kohë më të shpejtë. Ka qindra shembuj si ky, dhe ndërsa ne vazhdojmë ta rafinojmë teknologjinë dhe të zgjerojmë përdorimet e saj, do të ketë me qindra të tjera – të gjitha për të ndihmuar klientët tanë që të bëjnë më shumë.


“Në Cat Tech Center, ja përse është Ekselencia e Zhvillimit të Produktit të Drejtimit.” ■



Fasiliteti i vizualizimit zhytës të klasit botëror u lejon inxhinierëve që të ndërveprojnë në mënyrë të natyrshme me projektin e tyre virtual.







*“Redukton punën, rrit efincencën, sigurinë dhe fitueshmërinë në të njëjtën kohë.”*

# KUR PERFORMANCA ME PRECIZION PËRPUTHET ME RENDIMENTIN



Pesha minimale, ndryshueshmëria maksimale: ndërfaqe e lehtë me modulet e çengelit dhe një gamë e bashkuesve të shpejtë.

**“Me Rototilt ne kryesisht kemi zgjeruar funksionalitetin e një game makinash tashmë fleksible,” thotë Per Norell, menaxheri i komunikimeve të marketingut Indexator. “Ekskavatorët bëhen më eficientë, kur mund të gërmojnë, të anohen dhe të rrotullohen me një lëvizje të vetme, duke i lejuar operatorit që të punojë mbi, nën dhe përreth të gjithë tipeve të pengesave. Operatorëve nuk ju duhet më që të ripoziciojnë ekskavatorin për të gjetur këndin e drejtë për kovën apo çengeljin e tyre – Rototilt u jep atyre një nivel të ri precizoni pikërisht aty ku ju nevojitet.”**

E vendosur në Vindeln, Suedi, fabrika Indexator që është një pronë familjeje ka 230 punonjës, që prodhojnë një aksesorë makine me një gamë binjake për konsumatorët në Norvegji, dhe kohët e fundit ka njoftuar Marrëveshjen e Shitësve Aleatë që do të thotë Rototilt është pjesë e portofolit të Mjeteve të Punës Cat.

Rototilt shkon një hap më tej se sa rotatorët bazë të Indexatorit për makinat e pyllit, vinçat kamionë dhe manipulimin e materialit. Rototilt është një zgjidhje teknike me një marzh krimb hidraulik të fuqishëm

me rrotullim të pafund 360° në të dy drejtimet dhe me një fleksibilitet animi në 40 gradë. Furçat, prerësit e asfaltit, pirunët, kovat dhe çengeljat mund t'i atashohen ekskavatorit në sekonda me bashkuesin e shpejtë të integruar të Rototiltit. Disponohen 5 masa, 90 për qind e ekskavatorëve nga 3 në 30 ton me koston më të ulët rreth €10,000 dhe më e madhja €25,000, Rototilt redukton punën, rrit efincencën, sigurinë, saktësinë dhe fitueshmërinë – në të njëjtën kohë.

## **SHPËRNDARJA KULTURORE**

“Rototilt është pothuajse një pjesë e rëndësishme e peizazhit Skandinav të ekskavatorëve. Operatorët në këtë rajon janë trajnuar në mënyrë specifike në punimet e ndërtimit dhe aftësitë e nevojshme për manipulimin e makinës në shkollat e industrisë të miratuara nga qeveria,” thotë Per. “Dhe për trajnimin për ekskavatorë, rotaroti tilt është pjesë e pajisjes standarde të nevojshme. Nga ana kulturore, ne jemi adoptues të hershëm dhe mezi presim që të përdorim çdo gjë që na ndihmon për tu bërë më eficientë. Si të tillë, kemi 20 vjet përvojë në mjetin e punës Rototilt.”





Figurinë, saktësinë  
shpë.”

Kohët e fundit, Indexatori ka parë shitje gjithnjë në rritje, dhe në Norvegji shumë kontrata aktualisht specifikojnë përdorimin Rototilt: kur operatorët hyjnë në një tender për punime, ata konsiderohen në mënyrë tipike në qoftë se mund të sjellin një Rototilt në punë.

#### AKSESI I LEHTË NDAJ PËRFITIMEVE TË SHUMËFISHTA

Indexatori e furnizon Rototiltin tek tregtarët si PON, i cili pastaj i monton makinat për klientët si Johan Rognerud AS, shoqëria e ndërtimit që ka gëzuar përfitimet e Rototilt për 14 vjet.

Johan Rognerud menaxhon një flotë prej 40 Cat, duke përfshirë Cat D6, D11, një D10, D8, 771D, dy 772, katër 775, dymbëdhjetë ekskavatorë 307 deri 385, tre M316, dy 329 dhe një prodhim të ri M140. Babai i tij e filloi shoqërinë si operim për bujqësinë në vitin 1953 me dy ngarkues me kova, dhe Johan e zgjeroi gamën e tij në vitin 1975 kur ai bleu një D6 për 7,000 NOK (rreth €900) nga një tregtar vendor PON. “Pati shumë arsye përse ne zgjodhëm Cat,” thotë Johan, “çmimi i mirë i dorës së dytë, shërbimi i mirë dhe pjesë këmbimi shumë të mira.” Kur shoqëria filloi të sillte projekte të

mëdha ndërtimi, ju shtua flotës një D9H në vitin 1978, dhe në vitin 1983 u soll ekskavatori i parë a 215.

Sot shoqëria e Johanit është pjesë e AF Group, kontraktori i tretë më i madh në Norvegji që punëson 105 njerëz. “Ne punojmë në të gjithë Norvegjinë dhe në Groenlandë,” thotë Johan, “ne e ndjekim punën aty ku na çon ajo.” Kjo ka përfshirë pistat e aeroporteve të Norvegjisë, duke përgatitur dhe përfunduar kantiere për fabrika dhe komplekse strehimi dhe një konstante e veçantë: E6.

Më tepër ►

VENDNDODHJA:  
OSLO,  
NORVEGJI



Mësoni më tepër për Rototilt dhe Mjetet e Punës Caterpillar:  
[www.uk.cat.com/worktools](http://www.uk.cat.com/worktools)

Johan Rognerud (majtas) diskuton meritat e Rototiltit me Per Norell, menaxheri i komunikimeve të marketingut.



## ÇFARË THONË OPERATORËT

Vetle Bergman Nyborg po punon Fuglåsen në Langhus, Norvegji, me një ekskavator Cat 324DL të pajisur me një Rototilt. Detyra që duhet të bëjë ekipi në 300,000 metra katrorë kantier është që të lëvizë një milion metra kub granit. Në tetor ata duhet ta ndryshojnë atë që tani duket si një gurorë në një kantier niveli për ndërtimin e një qendre logjistike. "Pa Rototiltin mua do të më duhej në mënyrë konstante ta ripozicionoja ekskavatorin, ta kontrolloja, ta lëvizja, për të bërë të njëjtën punë. Tani unë thjesht e mbaj makinën në një vend dhe i përqendroj të gjitha lëvizjet tek kova. Do të thosha që ai i bën gjërat 95 për qind më të shpejta, më të lehta."

Atle Sandnes po punon në një projekt strehimi të ri me një M316D. "Na u deshën 200 turne për të qenë në gjendje që të përdornim Rototiltin pa menduar," tha ai. "Por kjo është mjaft normale. Tani unë mund të punoj rreth 100 për qind më shpejt dhe duhet të them, në qoftë se do të punoja pa të, për mua do të ishte një handicap."



### "SA E KA PËRMIRËSUAR PUNËN TIME? UNË DO TË THOSHA RRETH 100 PËR QIND"

"E6 është autostrada kryesore këtu në Norvegji," shpjegon Johan, "duke u shtrirë nga veriu në jug me 2,400 kilometra. Unë e ndihmova babain tim të ndërtonte disa pjesë të saj kur kam filluar për herë të parë 37 vite më parë. Dhe vitin e kaluar ne e përfunduam punën në të njëjtën gjatësi ruge, për ta zgjeruar atë me dy korsi. Për dy vjet punuam me 60 makina për të shtruar 25 km rrugë. Pa Rototilt, do të na merrte shumë më tepër kohë." Johani fillimisht përdori Rototiltin 14 vjet më parë. "Është e vështirë të thuash sa shumë më shpejt nga e ka përfunduar punën," thotë ai, "por ndoshta 100 për qind." Dhe me operatorët që punonin deri në 15 kantiere në të gjithë Norvegjinë, ai sigurisht që ka mjaft përvojë për të pretenduar.

### PËRPUTHJA E KËRKESËS KONSTANTE ME PERFORMANCËN E PRECIZIONIT

Vilmundur Theodorsson, i shoqërisë PON, menaxher produkti për ekskavatorët kryesorë, ka një teori. "Rreth 90 për qind e ekskavatorëve që ne shesim janë të pajisur me Rototilt sepse ai e sjell makinën në një nivel totalisht të ri. Një operator mund ta kryejë punën e 3 ose 4 njerëzve, kryesisht. Një kovë ose çengel që mund të rrotullohet 360 gradë, të anohet 40 gradë – klientët tanë këtu me të vërtetë e trajtojnë Rototiltin si standard për shkak të përfitimeve të veçanta që ai sjell në punën e tyre. Merr më pak kohë që të montohet Rototilti në një makinë Cat se sa në makinat e tjera sepse ato vijnë standarde me hidraulik ndihmës proporcional. Dhe është

gjithashtu rotatori më i lehtë dhe më i fortë që ekziston, që livron deri në 200 kN forcë gjermuese me një kovë 1.6.

"Në Skandinavi, ky treg vetëm do të rritet. Aktualisht ne po lëvizim rreth 200 ekskavatorë në vit, shumica me Rototilt të paramontuar. Për klientët e mi, kjo është thjesht ekonomi me 20 vjet provë, dhe një produkt që ka të njëjtat nivele të besueshmërisë si pajisja Cat. Një nga ekskavatorët 16-ton të Johanit punoi me një Rototilt për 8,000 orë dhe e vetmja mirëmbajtje e nevojitur ishte ndryshimi i vulave."

"Precizioni dhe manovrueshmëria janë shkaqet kyçe të blerjes," thotë Vilmundur. "Kur ju punoni në një kanal, ju mund të gërmoni përreth tubacioneve, mund të pastroni përreth tubave pa e lëvizur ekskavatorin. Ose në qoftë se bëni gradim ose rregulloni peizazhin, ju mundet ta përdorni kovën pothuajse si thikë, është shumë e saktë dhe gjë e mrekullueshme që të shikosh operatorët me përvojë kur punojnë, që bëjnë një punë që normalisht do të duhet ta përfundonin dy ose më shumë njerëz." ■



Operatorët në punë: Atle Sandnes (në krye) dhe Vetle Bergman Nyborg.





# NDËRTO QË TË RINDËRTOHET

Caterpillar ka ndërtuar pajisje të forta, udhëheqëse në industri që prej vitit 1925. Dhe që prej vitit 1985, Rindërtimi i Certifikuar Cat (CCR) dhe Treni i Certifikuar me Energji (CPT) kanë transformuar pajisjet e vjetruara, në makineri të reja që janë po aq të reja sa dhe dita kur ato mbërrijnë .

Sot, CCR dhe CPT kanë rindërtuar me sukses më tepër se 5,000 makina në gjendje si të reja për një fraksion të koston së pajisjes së re. "Ta themi në këtë mënyrë," thotë Marcus Pitt, menaxheri për Finning për Marrëveshjet e Trenit me Energji & Marrëveshjet e Mbështetjes së Klientit, "një makinë e re kushton 100 për qind. Një CCR kushton në mënyrë tipike rreth 60 për qind. Mbi dy jetët e makinës ju keni shpenzuar 160 për qind më tepër se 200 për qind."

Hamza W. Zahid, menaxheri i shitjeve të pjesëve dhe shërbimeve të Traktorit Zahid, Rajonit Perëndimor, bie dakord. "Në përgjithësi ne bëjmë CPT me afërsisht 35 deri 50 për qind të koston së një makine

*"Unë mendoj gjithashtu se garancia prej 12 muajsh e Caterpillar është një nga faktorët kyç për shitjen e konceptit CCR/CPT."*

të re, dhe CCR me afërsisht 60 për qind të koston së makinës së re. Është një avantazh i madh dhe një pikë shitje për klientët tanë sepse ata marrin një rinovim pothuajse të plotë për një fraksion të koston të asaj që makina e re do tu kushtonte atyre."

## KUJDES DETAJET

Kërkesat shtrënguese të cilësisë së Caterpillar e bëjnë atë prodhuesin e vetëm me një program rindërtimi që garanton performancë si të reja. "Ne marrim kërkesa të rregullta për të kryer rindërtimin e CPT, veçanërisht nga klientët që janë të kënaqur me cilësinë dhe rezultatin e rindërtimeve të mëparshme" thotë Hamza Zahid.

Një faktor tjetër shtytës është disponueshmëria e pajisjes së re. "Ne po shikojmë tani për kamionin 777 për minierat, produkti kryesor i industrisë nxjerrëse në Mbretërinë e Bashkuar. Koha e realizimit për to

mund të jetë tetë muaj deri në një vit. Kështu që klientit zgjedhin që të rindërtojnë për tu siguruar që të mund të vazhdojnë punën," thotë Marcus.

Në varësi të pajisjes, një CCR merr një fraksion të kohës që duhet për të porositur një makinë të re. Është një strategji afatgjatë e klientëve që të përfitojnë për të maksimizuar fitimet dhe produktivitetin.

## A 12 MUJ GARANCI ME ÇDO RINDËRTIM TË CERTIFIKUAR CAT

Kur duhet që pronarët/operatorët të shikojnë për Rindërtimin e Certifikuar? Hamza Zahid thotë, "Ne kemi rindërtuar D11R me 38,000 orë. Rindërtimet tona CPT në mënyrë tipike kanë qenë midis 10,000 deri në 25,000 orë, ndërsa ÇR janë bërë me +30,000 orë. Gjithashtu mendoj se garancia prej 12 muajsh e Caterpillar është një nga faktorët kyç për shitjen e konceptit ÇR/CPT. Me Rindërtimet e Certifikuara Cat, klientët marrin përfitime të ngjashme me garancinë 12 muajsh të makinave të reja, me mundësinë për të shtyrë garancinë me një kosto shtesë të vogël. Klientët tanë dëshirojnë që të dinë se Caterpillar garanton makinat e tyre. Ne kemi pasur tashmë klientë me të cilët kemi rindërtuar makinat për 10,000 orë pa probleme."

## NJË RINDËRTIM NDËRTON FITIME

Vija fundore është Rindërtimi i Certifikuar Cat ose Treni me fuqi të certifikuar është bërë një vendim i zgjuar popullor i biznesit në të gjithë globin. Peter Sergeys, menaxheri i oficinave në Bergerat Monnoyeur, Belgjikë, shikon një interes të vazhduar. "Nga një pikëpamje ekonomike e thjeshtë, ka kuptim të shëndoshë biznesi që të përfitohet nga jeta e dytë e një makine," thotë ai. "Ju përfitoni performancën e re të makinës për një fraksion të koston së blerjes së një të reje". ■



Marcus Pitt, menaxher i produktit në Finning dhe Peter Sergeys, menaxheri i oficinave në Bergerat Monnoyeur, Belgjikë.

ÇR = rindërtimi total i makinës  
CPT = rindërtimi i trenit me energji  
CPT + = rindërtimi i trenit me energji + çdo komponent tjetër që doni të shtoni



Te rejat më të fundit të Rindërtimit të certifikuar:  
[www.parts.cat.com/parts/cat-certified-rebuild](http://www.parts.cat.com/parts/cat-certified-rebuild)



# NDEZJA PËR NJË TË ARDHME MË TË QENDRUESHME

## SEGMENTET E TREGUT DETAR:

- Në det
- Rimorkim & Shpëtim
- Ngarkesë
- Rrugë ujore në tokë
- Thelluese
- Peshkimi
- Mjete Argëtimi
- Udhëtimi
- Tragjet
- Qeveritare / Ushtarake

Si prodhuesi udhëheqës botëror i pajisjeve industriale, Caterpillar shkakton ndryshim në të gjithë globin nëpërmjet makinave legjendare të markës Cat® të verdhë. Ndërsa makinat Cat kanë luajtur një pjesë integrale në formimin e infrastrukturës botërore të bazuar në tokë, zgjidhjet e Cat për energjinë në det kanë siguruar energjinë për industrinë botërore të transportit për 80 vitet e kaluar, duke rritur shpejtësinë dhe eficientësinë e industrisë detare globale.

Me seli në Hamburg, Gjermani, sistemet e Energjisë Detare Caterpillar (CMPS), garanton zgjidhjet detare të klasit të parë dhe shërbimet për klientët në të gjithë

botën. Prodhimi i fasiliteve në të gjithë globin, prodhimi i njësive shtytëse, energjia ndihmëse dhe gjeneratorët e energjisë për tu përdorur në oqean, anijet komerciale dhe ato për argëtim. CMPS është kthyer në një udhëheqës tregu novator duke garantuar klientët me një spektër të gjerë të ofertave të energjisë nëpërmjet dy markave të saj: Cat dhe MaK. Linja e produktit Cat mbulon motorët shtytës nga 93 deri në 5,650 kW motorët ndihmës nga 162 deri në 5,420 kW dhe kompletet e gjeneratorëve nga 11 deri në 5,200 kW Linja e produktit të shpejtësisë mesatare MaK përfshin motorët e shtytjes dhe ata ndihmës si dhe kompletet e gjeneratorëve me gamën e fuqisë nga 1,020 deri në 16,000 kW Kjo gamë



e produkteve i lejon CMPS që të plotësojë nevojat e segmenteve të ndryshme të anijeve, që nga ato për argëtim deri tek ato ushtarake dhe për rrugët ujore në tokë, që nga peshkimi deri tek rimorkiatorët dhe anijet e shpëtimit në det dhe ato të ngarkesës dhe tragetet.

#### **SISTEMET DHE ZGJIDHJET, MË TEPËR SE SA MOTORËT**

Gjatë 80 viteve të kaluar, kompleksiteti i operacioneve me klientin është rritur, gjë që e ka çuar CMPS që të diversifikojë ofertat për të plotësuar nevojat e industrisë. David Surroca, menaxheri rajonal i shitjeve CMPS për Evropën, Afrikën, Lindjen e Mesme dhe CIS, shënon se CMPS është zhvilluar nga shitja e motorëve diesel tradicional deri në zgjidhjet e sistemit tërësor. Për shembull, ai përmend segmentin në det i cili përfshin shërbimet detare më tradicionale për vajin dhe gazin, por gjithashtu fushën tepër të re të gjenerimit të energjisë me erë në det. "Anijet instaluese të turbinës së erës në det janë projekte tepër komplekse me kërkesat e energjisë së lartë. Kompleksiteti dhe vetë madhësia e këtyre projekteve shpesh kërkon që CMPS të sigurojë sisteme tërësore të integruara që

përfshijnë çdo gjë prej completeve të gjeneratorit, centraleve të energjisë elektrike me diesel, sistemet e shtytjes për të gjithë lundrimet në bord dhe sistemet e komunikimit," tha Surroca. "Kjo është ajo që vlerësojnë klientët. Përveç sigurimit të produkteve të shpejtësisë të mediumit MaK për anijet e mëdha tregtare, ne garantojmë gjithashtu zgjidhje të sistemit për anijet mbështetëse të tilla si ato që shtrojnë kabullin, varkat e ekuipazhit dhe anijet e mirëmbajtjes. Për këto aplikime, zakonisht ne sigurojmë produktet tona të shpejtësisë të lartë të markës Cat dhe sistemet përkatëse."

Më tepër ►



Selia rajonale CMPS e EAME ndodhet në Hamburg, Gjermani.



Inxhinierët dhe mekanikët nga të gjithë vendet e prodhimit kanë njohuritë dhe shtysën që t'i sjellin produktet novatore në treg.

Ofertat e produktit nuk janë i vetmi axhustim që CMPS ka angazhuar për të shpjeguar tregun ndryshues detar. Surroca shënon se CMPS tani u ofrohet bizneseve heterogjene detare me strategji me segmente specifike dhe ekupe segmentesh të dedikuara. "Ne pranojmë se asnjë klient i yni nuk është identik me një tjetër. Klientët tanë operojnë në mjedise shumë të ndryshme dhe ne duam të sigurojmë për çdo klient, edhe me kërkesat më të specializuara, se do të marrë produkte dhe mbështetje të përshtatur për të," tha Surroca. "Për të garantuar këtë, klientët tanë gjithmonë mund të presin nivelin më të lartë të ekspertizës dhe shërbimit, ne kemi marrë hapin për të inkorporuar ekspertë të segmentit të vërtetë në ekipet tona përreth globit. Ekspertët që kuptojnë se çfarë duhet tu livrojmë klientëve tanë, për t'i bërë ata edhe më të suksesshëm."

#### MBËSHTETJA E KËRKESËS PËR ENERGJI TË PASTËR

Body Referimi i Surrocas për segmentin në rritje të Energjisë së Erës në Det nuk është koincidençë. Në Evropë, kjo industri që po zhvillohet përfaqëson një nga segmentet më të shpejta në rritje në mjedisin detar, veçanërisht në Mbretërinë e Bashkuar dhe Gjermani, ku miratimet e qeverisë për kantiere të reja në det e kanë përshpejtuar hapin e ndërtimit.

"Tregu i energjisë së erës në det është një segment i ri emocionues me teknologjinë e re novatore dhe një qëllim i madh – për të zhvilluar zgjidhje të qëndrueshme të energjisë," shënoi Surroca. "Qasja

*Quote "Ne ofrojmë asistencë, ekspertizë dhe infrastrukturë nga projekti deri në mbështetjen pas shitjeve."*

jonë me segmente specifike për industrinë detare na ka lejuar që të zhvillojmë zgjidhjet të klasit më të mirë që u mundësojnë klientëve tanë të lundrojnë me sukses duke sfiduar rregullimet e emetimeve dhe duke përmirësuar qëndrueshmërinë e përgjithshme të operimeve të tyre të parkut të erës në det."

#### NJË LOJTAR KRYESOR NË NJË BIZNES NË ZGJERIM

Fillimisht i krijuar si një biznes me një njeri në vitin 2000, shoqëria Daneze A2SEA ishte mes të parave që ofroi zgjidhje për transportin, instalimin dhe servilin për industrinë e parqeve të erës në det. Shoqëria është rritur dhe është bërë një lojtar kryesor në segment, duke ruajtur dhe duke operuar me flotën e saj me anije dhe pajisje të projektuara në mënyrë të posaçme: Energjia e Detit, Punëtori i Detit, Energjia e Detit dhe Instaluesi i Detit. Anija e tyre e fundit, 'Instaluesi i Detit' është një anije e instalimit të gjeneratës tjetër, aktualisht duke u ndërtuar në Kinë dhe do të vihet në punë së shpejti. E projektuar nga shoqëria Holandeze GustoMSC, ajo

do të mbartë instalime të turbinës së erës në kushtet sfiduese që do të hasen më tej në det dhe në ujërat më të thella. Energjia për anijen sigurohet nga gjashtë komplete Gjeneratorësh Shtytës Elektrikë me diesel MaK 9 M 25 C, secili me fuqinë e llogaritur 2,880 ekW.

"Në një projekt si ky, ne punojmë me klientin që nga faza e hershme e projektimit. Ne sigurojmë mbështetjen tonë gjatë studimit të fizibilitetit, kuptojmë kriteret e performancës së anijes kyçe dhe ofrojmë një zgjidhje të përshtatur e cila i përshtatet kërkesave specifike të anijeve," tha Alexander Kohse, menaxheri i segmentit të erës në det. "Në mënyrë tipike kjo do të përfshijë 6 deri në 12 muaj menaxhim projekti, bashkë me mbështetjen e aplikimit dhe instalimit drejt finalizimit. Projektimi dhe ndërtimi i këtyre anijeve është një operacion global i vërtetë, duke i bërë këto projekte që t'i përshtaten rrjetit global të ekipit të Caterpillar dhe tregtarëve tanë detarë të Cat. Ne mund të ofrojmë mbështetjen, ekspertizën dhe infrastrukturën tonë në çdo gjë, që nga projektimi dhe ndërtimi deri në livrimin dhe mbështetjen pas shitjeve."

Kohse shënoi, Caterpillar e ka krijuar me shpejtësi veten si një nga furnizuesit kryesorë të industrisë për zgjidhje në sektorin e erës në det. "Aktualisht ne jemi të angazhuar në një numër projektesh të tillë çdo vit plus shumë projekte të tjera për lloje më të vogla anijesh – të tilla si barkat e ekuipazhit që e marrin dhe e çojnë stafin në parqet e erës."

#### TRANZICIONET E ARDHSHME

Megjithëse sot biznesi kryesor i CMPS janë akoma motorët detarë të shtytjes me diesel dhe kompletet e gjeneratorëve, Kohse shënon një ndryshim po ndodh tani, në mënyrë specifike me anijet më të sofistikuara për segmentin detar. "Në lidhje me energjinë, ne po shikojmë sistemet elektrike të shtytjes me diesel, me katër deri në tetë komplete gjeneratorësh me diesel që sigurojnë energjinë për nevojat e anijes për të gjitha mënyrat e operimit. Dhe në një afat të mesëm, klientët tanë do të presin dhe do të vlerësojnë edhe më shumë tranzicionin tonë për tu bërë një sigures total sistemesh. Gjithmonë me synimin për të ruajtur pozitën tonë si furnizues udhëheqës i teknologjisë në industri dhe si një shoqëri e angazhuar për të furnizuar klientët tanë me zgjidhje të qëndrueshme që i bën ata të suksesshëm ndërsa mbrohet mjedisi." ■

#### Komuniteti On-line:

caterpillar.lithium.com  
facebook.com/caterpillarmarine  
youtube.com/caterpillarmarine  
twitter.com/caterpillarinc





*“Për anijet e instalimit motorët MaK me fuqi të lartë janë zgjidhja më e mirë.”*



Në shërbim që prej vitit 2002, anija e instalimit Sea Power mbart deri në tri turbina në gamën 2.3 MW deri në 3.6 MW dhe operon në thellësitë ujore deri në 24 metra.

## INSTALUESI I DETIT, ME ENERGJI NGA PERFORMANCA SUPERIORE – MaK, BESUESHMËRI DHE KONFORT

Thony Askjaer, A2SEA, Kryeinxhinier i Instaluesit të detit thotë: “Anija e re është e pajisur me gjashtë komplete Gjeneruese të Shtytjes Elektrike me Dise MaK 9 M 25 C. Ata do të gjenerojnë energji elektrike jo thjesht për shtytje, por për të gjitha funksionet operationale shumë të ndryshme të anijes. Njësitë MaK operojnë vetëm me 750 rpm, duke dhënë një kombinim mbresëlënës të një autputi të energjisë, të besueshmërisë së lartë – të ndihmuar nga fakti se ata kanë 40 për qind më pak pjesë lëvizëse sesa motorët diesel konvencional – dhe vibracion dhe zhurmë të ulët. Si rezultat, anija do të ofrojë një nivel shumë të lartë performance, e kombinuar me komfort akomodimi të përmirësuar shumë për ekipe të instalimit. I shtohet kësaj fakti që projekti me kuvertë të pastër i anijes na lejon që të mbartim dhe të instalojmë deri në 10 turbina komplete të erës në të njëjtën kohë, dhe ju mund të shikoni se ‘Instaluesi i Detit’, kur vihet në shërbim këtë verë, do të përfaqësojë në hap të rëndësishëm përpara në produktivitetin për klientët tanë të parqeve të erës në det.”





VENDNDODHJA:  
BORDO, FRANCË



# TA ÇOJMË ATË EKZAKT NË KOHË TË NDIHMOJMË JEAN JACQUES LE MOAL QË TË LIDHET ME NJERËZIT NË TË GJITHË AFRIKËM



Motor gradues i Cat në veprim në Çad duke niveluar rrugën.

Sogea Satom, pjesë e French Vinci Group, është një shoqëri ndërkombëtare udhëheqëse në ndërtimin dhe inxhinierinë civile që operon në të gjithë Afrikën. Nëpërmjet pasionit të tyre për Kontinentin Afrikan, Drejtori Menaxhues Philippe Chavent dhe ekipi i tij kanë ndërtuar një shoqëri me përvojë të pa rivalizuar në ndërtimin e rrugëve dhe zhvillimin e infrastrukturës. Ata janë një përdorues afatgjatë i makinave Cat, kështu që çfarë punësh marrin përsipër ata, çfarë rolesh luajnë makinat Cat, dhe si ndihmojnë tregtarët Cat për të kontribuar me efikasitet dhe suksesin e Sogea Satom? Ne e pyetëm Drejtorin e Logjistikës të Sogea Satom dhe Menaxherin e Flotës Jean Jacques Le Moal.

## SË PARI, NA THONI PËR SOGEA SATOM DHE PËRFSHIRJEN E SAJ NË AFRIKË.

"Shoqëria i filloi operacionet atje në vitet 1930 me hapjen e fabrikës Sidi Bouknadel në Morok dhe livrimin e tubacioneve të para të furnizimit me ujë për Rabatin. Në vitin 1948 ne i filluam operacionet në Gabon, dhe në vitin 1951 ne nënshkruam kontratat e para për punimet në rrugë në Niger dhe Çad.

"Ne operojmë në katër sektorë të biznesit: punimet në rrugë dhe lëvizjet e dheut, inxhinierinë civile dhe ndërtimin dhe inxhinierimin hidraulik dhe mjedisor. Dhe ne mbulojmë katër zonat kryesore: Afrikën e Veriut, Afrikën Perëndimore dhe Madagaskarin, Afrikën ekuatoriale dhe Afrikën Qendrore dhe Lindore. Në vitin 2011 ne operuam në 22 vende Afrikane

dhe patëm një xhiro prej 870 milionë Euro. Rreth 53 për qind e kësaj vjen nga punimet e rrugës dhe të dheut, me inxhinierimin civil që gjeneron më pak se 30 për qind. Ne punësojmë rreth 10,000 njerëz."

## CILA ËSHTË E KALUARA JUAJ DHE ÇFARË ROLI LUANI JU NË SOGEA SATOM?

"Unë jam një inxhinier me kualifikim. Kam kaluar shumicën e karrierës time në industrinë e ndërtimit në Francë. Me shoqërinë Chantiers Modernes, për shembull, kam qenë përgjegjës për të gjitha instalimet

*"E dimë se me Caterpillar ne do të gjejmë cilësi konsistente të lartë."*

në kantieret e shoqërisë, duke përfshirë oficinat, fasilitetet për përpunimin e betonit, banesat, një gamë tërësore e fasiliteteve. Kohët e fundit theksi im ka qenë në projektet ndërkombëtare, veçanërisht me Sogea Satom. Si menaxher i logjistikës unë përgjigjem për një gamë aktivitetesh dhe fasilitetesh në një zonë të madhe gjeografike në të gjithë Afrikën. Nuk është si në Evropë, ku një projekt madhor rrugësh do të ndahet në disa 'lote', ku secili trajtohet nga një kontraktor i ndryshëm. Në Afrikë, ju përgjigjeni për të gjithë projektin, dhe kjo e bën logjistikën kritike. Distancat janë më të mëdha dhe zinxhiri i furnizimit më i gjatë. Kështu, na nevojitet që ta kryeni saktë që





# NË AFRIKË

herën e parë, në çdo kohë. Kështu unë udhëtoj shumë; rreth 18 udhëtime në vit, në distanca të gjata.”

## **CILA ËSHTË PËRVOJA JUAJ ME MAKINAT CAT NË AFRIKË?**

“80 për qind e flotës tonë përbëhet nga makinat Cat dhe kjo nuk është rastësore. Shumë thjesht, Caterpillar është referencë. Kur krahasojmë pajisjet ne gjithmonë përdorim makinat Cat si masë për atë se si duhet të performojë makina. Ne e dimë se me Caterpillar, do të gjejmë cilësi të lartë konsistente, qoftë në një ngarkues me rrota apo në një ekskavator. Ne gjithmonë nuk mund të mbështetemi tek kjo në vend tjetër.

“Gjithashtu, është e rëndësishme që Caterpillar të ofrojë një linjë produkti complete të mbështetur nga servisi i mirë. Ne kemi pika servisi, për shembull në Bamako, Gabon, dhe na nevojitet që të kemi njerëz kompetent. Na nevojitet që të kemi trajnim gjithashtu. Ne mbulojmë 33 milionë kilometra katrorë dhe duhet të jemi të lëvizshëm. Një kantier pune lind, jeton dhe pastaj vdes. Kjo është ndryshe nga, për shembull, një klient minierash, i cili mund të jetë në atë vend për 20 vjet. Kështu, është e rëndësishme që të mbështetemi nga tregtarët që gjithmonë të jenë të gatshëm të plotësojnë kompetencat tona.”

## **KËSHTU, CILA ËSHTË PËRVOJA JUAJ ME TREGTARËT CAT?**

“Ne punojmë me një numër tregtarësh Cat në të gjithë Afrikën – Tractafric, JA Delmas, Mantrac-Unatrac, Henri Fraise dhe të tjerë. Ata e dinë se çfarë makinash ne

ofrojmë, cila mund të adaptohet për t’ju përshtatur qëllimeve tona dhe si ta bëjnë atë. Ne gjithmonë kemi konstatuar se ata reagojnë shpejt dhe e adaptojnë mendimin dhe strategjitë e tyre për të plotësuar nevojat tona. Një shembull ishte në Mali ku, për shkak të disa problemeve, kantieri i punës duhet të pushonte punën. Urdhrat e planifikuar për makina të reja duhet të ndaloheshin dhe makinat duhet të lëvizeshin nga një vend në tjetrin. Për të bërë gjëra të tilla, në mënyrë të suksesshme, ju nevojitet fleksibilitet dhe koncesione si nga ne edhe nga tregtarët tanë – dhe kjo është ajo çka ne e marrim nga tregtarët tanë Cat. Është veçanërisht e vlefshme për ne, gjithashtu që të kemi – edhe tregtarët tanë në vend – një ndërmjetës i vetëm Caterpillar. Për ne ky është Vincent Migeotte, menaxheri i llogarive globale Caterpillar. Ai flet si zëri i vetëm i Caterpillar dhe punon ngushtë me tregtarët Cat.

“Gjithashtu, ne e dimë se kur merremi me Caterpillar, ata do të kryejnë biznesin në mënyrë të rregullt, logjike, me vendime të mençura në çdo hap. Ne përfitojmë nga marrëdhënia e ngushtë midis Caterpillar, tregtarëve të saj dhe bazës së klientëve.”

Më tepër ►



Vincent Colleu, menaxher i përgjithshëm i shitjeve të ndërtimit, Joel Mikaelian, menaxher i përgjithshëm i JA Delmas, Jean Jacques Le Moal, drejtor i Sogea Satom dhe Richard Ruspil, menaxher ekzekutiv i Construction & Quarries.

### **PËR MOMENTIN KA NJË EVOLUCION KONSTANT TË MAKINAVE NË VAZHDIM. SI NDIKON KJO NË PUNËN TUAJ NË AFRIKË?**

“Për ne, procesi i evolucionit elektronik ka qenë pa probleme dhe progresiv. Ai është bërë në mënyrë progresive dhe ndryshimet janë përvetësuar për tu përdorur në terren. Disa vende Afrikane nuk kanë norma apo legjislacion për gjëra të tilla si emetimet por Caterpillar do të sigurojë që pajisja e tij të jetë e Etapës III e certifikuar. Accugrade është përdorur në Burundi në një gradues motorik Cat 14M dhe sigurisht ai mund të rimontohet. Ai punon shumë mirë për ne, me operatorët tanë të trajnuar në Qendrën e Demonstrimit Cat në Malaga, Spanjë, kështu që ata mund ta montojnë pajisjen në makinë vetë.”

### **SI E SHIKONI TË ARDHMEN PËR BIZNESIN TUAJ NË AFRIKË?**

“Konkurrenca nga Kinezët është shumë e fortë por ne e shikojmë se Caterpillar dhe makinat Cat na ofrojnë ne dy asete të rëndësishme; inovacionin në mënyrë që

riparimet dhe rindërtimet e motorëve. Rreth 25 për qind e flotës të makinave tona transferohet midis vendeve si të jetë e nevojshme dhe këto makina që nuk rivendosen riparohen dhe pastaj rishiten ose në vend ose kudo në botë nëpërmjet tregjeve të pajisjeve të përdorura.

“Me 90 për qind të stafit tonë me origjinë nga Afrika, ne varem nga trajnimi dhe mësimi vendor. Kështu, ne kemi formuar partneritete me shkollat vendore dhe universitetet. Operatorët dhe teknikët mund të trajnohen në katër muaj, por trajnimi i operatorit realisht duhet të vazhdojë, meqenëse operatorët vijnë dhe ikin. Teknikët qëndrojnë me ne në një afat më të gjatë dhe ata lëvizin nga një kantier pune në një tjetër. Kështu, teknikët tregtar të Cat shpesh vijnë në kantier për të trajnuar teknikët vendorë. Dhe operatorët tregtarë mund të mbështeten për të punuar në kantieret tona të punës”

### **PËRFUNDIMISHT CILA ËSHTË AJO QË JU PËLQEN MË TEPËR PËR PUNËN QË BËNI?**

“Fakti që shpesh punoj në zona të largëta, që do të thotë duhet të trajtoj çdo hap logjistik, nga fillimi deri në fund. Variacioni është stimulues në një mënyrë që nuk e gjeni dot kurrë në Evropë. Unë e dua këtë diversitet thjesht nuk mund ta mundës atë.”

*“Ne presim të vazhdojmë që të shikojmë 10 apo më shumë për qind rritje në biznes.”*

punojmë dhe aftësinë për të reaguar në mënyrë efektive ndaj kushteve vendore specifike. Në këto drejtime, për të përdorur një analogji me futbollin, ne luajmë në liga të ndryshme nga konkurrentët tanë. Me Sogea Satom, mbështetur nga cilësia dhe tregtarët e Caterpillar, klientët e dinë që ata do të marrin cilësinë që do tu jepet në kohë. Kështu, ne presim që të vazhdojmë që të shikojmë një rritje nga 10 deri në 15 për qind në biznes.”

### **QËNDRUESHMËRIA ËSHTË E RËNDËSISHME PËR OPERACIONET TONA SI E ARRINI ATË?**

“Në disa mënyra. Për shembull, ne kontribuojmë në komunitetet vendore. Kur ndërtojmë një kamp, ne ndërtojmë struktura të parafabrikuara. Këto pastaj kthehen në shkolla dhe/ose spitale për ti shërbyer komunitetit vendor. Dhe makinat tona shpesh rikushtëzohen nga situata vendore. Në Bamaco, Guinea Equatoriale, për shembull, ne kemi ofiçina që bëjnë

Z. Le Moal ia ka kaluar tani punën e tij Z. Lahuppe dhe në sfidat e tij të reja ai po fokusohet në dhënien e mbështetjes teknike në Afrikë dhe menaxhimin e materialeve në Departamentet Franceze në Det dhe në Territore (DOM/TOM). Ai po punon gjithashtu gradualisht drejt daljes në pension. ■

#### **FLOTA E MAKINAVE CAT**

- Traktorë të tipit me zinxhirë: 153
- Ngarkues të tipit me zinxhirë: 3
- Ngarkues me rrota: 149
- Kruajtës me motor: 29
- Gradues me motor: 171
- Ekskavator me zinxhir: 116
- Ekskavator me rrota: 16
- Kamionë: 23
- Kamionë të artikuluar: 8
- Ngarkues me kovë: 41
- Kompaktësues: 31
- Kompaktësues me rrota: 44
- Komplete gjeneratorësh: 654

#### **SHEMBUJ TË PROJEKTEVE TË ARDHSHE**

- Aeroporti Bamako
- Porti Cotonou
- Porti i Togos
- Zhvillimi mijëvjeçar i Burkinës
- Porti Conakry



Kontrolloni lajmet më të fundit tek:  
[www.cat.com](http://www.cat.com)





# BESIMI

Mjetet e punës Caterpillar u japin besimin që ta kryeni punën në mënyrë eficiente dhe efektive. Kjo vjen ngaqë ato karakterizohen nga një besueshmëri e jashtëzakonshme, cilësi e lartë dhe një jetë shumë e gjatë. Me gamën e gjerë të çengelëve tanë, multi-procesorëve, prerëset, copëtueset, çekiçët, kovat, bashkueset e shpejta dhe kompaktuesit, ju e dini që ju gjithmonë keni mjetin e duhur për çdo sfidë shkatërrimi dhe riciklimi.

Po kjo nuk është e gjitha. Kur përdoret në kombinim me makinat Cat, keni përshtatjen e përsosur të performancës. Po kjo nuk është e gjitha. Kur përdoret në kombinim me makinat Cat, keni përshtatjen e përsosur të performancës. Rendimenti i pandërprerë. Pajisja me të cilën mund të krenoheni. Një pikë e vetme kontakti. Dhe mbështetja e servisit tonë me pjesë këmbimi që nuk ka rivalë dhe rrjetin e gjerë të tregtarëve

**Punoni me besim. Zgjidhni mjetet e punës Cat.**  
[www.cat-worktools.com](http://www.cat-worktools.com)

© 2009 Caterpillar Inc. Të gjitha të drejtat e rezervuara, CAT, CATERPILLAR, logot e tyre përkatëse, "Caterpillar e verdhë" dhe veshja tregtare POWER EDGE, si dhe identiteti i shoqërisë dhe produktit që përdoret këtu, janë shenja tregtare të Caterpillar dhe nuk mund të përdoren pa leje. HEAX3942

**Teknoxgroup**





©2011 Caterpillar, All Rights Reserved. CAT, CATERPILLAR, their respective logos, "Caterpillar Yellow" and the POWER EDGE trade dress, as well as corporate and product identity used herein, are trademarks of Caterpillar and may not be used without permission.

[www.teknoxgroup.com](http://www.teknoxgroup.com)

**TEKNOXGROUP SHQIPERI SH.P.K.**  
Fshati Mucaj - Vore - Albania  
Tel: +355 44504747  
Fax: +355 44504750

